



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:236810

Datë: 14.04.2021

Numri i dokumentit: 01689796

**P.nr. 941/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**, me gjyqtarin Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurës A. A., për shkak të veprës penale sulm, nga neni 184 par.1, të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.2234/19, të dt. 16.10.2019, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, të dt. 23.03.2021, në prezencë të Prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari, të pandehurës A. A. në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.14.04.2021, përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri

**A. A.**, e bija e B. dhe nënës R., e gjinisë S., e lindur me dt. ...., në fsh. ...., K. ...., me vendbanim në ....., afër stacionit të trenit, identifikohet në bazë të Inj.nr. personal ....., të lëshuar nga MPB-Republika e Kosovës, ka të kryer 7 klasë të shkollës fillore, e papunë, e divorcuar, nënë e gjashtë fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, me nr. tel. ...., ashkali, shtetase e R. së Kosovës, mbrohet në liri.

### **ËSHTË FAJTORE**

**Për shkak se:**

Me dt. 24.09.2019 rreth orës 23:00, në rr. "....." në ....., pikërisht në kafiterin "....." duke përdorur forcën me dashje e kap për flokëve dhe bluze e pastaj nxjerr jashtë lokalit të dëmtuarën F. M., me ç' rast i shkakton frike dhe dhimbje, e cila ishte duke punuar në lokalit e lartcekur e po ashtu pasi që e pandehura ishte në ndikim të alkoolit kishte filluar të rebelohej duke thyer shishe të birrave dhe duke e goditur derën e lokalit,

-me çka ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 17 par.1, 21, 69, 81, 82 dhe neni 184 par.1 të KPRK-së si dhe nenet 365,498, 499 të KPP-se, të pandehurës i shqipton:

**VËREJTJE GJYQËSORE, Të pandehurës i tërhiqet vërejtja se në të ardhmen nëse përsërit veprimet e tilla do të dënohet me rëndë**

E pandehura obligohet që në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 20 € (njëzetë) euro, dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuara F. M. me vendbanim në rr.”.....” K- ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2234/19, të dt. 16.10.2019, kundër të pandehurës A. A., për shkak të veprës penale sulm, nga neni 184 par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 23.03.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe prezentë kanë qene prokurori i shtetit Muharrem Bajraktari, dhe e pandehura A. A..

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurën me të drejtat e saj, ku në këtë rast e pandehura ka deklaruar se i ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, iu është dhënë mundësia të pandehurës që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

E pandehura e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, e vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ndihet e penduar, kërkon falje palës së dëmtuar, premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës, ka propozuar që si rrethanë lehtësuese ti merret pranimi i fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që e pandehura e kupton

natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër te rastit 2019-DA-1924 te dt. 24.09.2019, deklarata ete dëmtuarës F. M. e dhënë ne polici me dt. 24.09.2019, raporti i oficerit F. B. e dt. 24.09.2019, deklarata e të pandehurës A. A. e dhënë ne polici me dt. 26.09.2019, si dhe shkresat tjera te lendes, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga e pandehura.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurës A. A., qëndrojnë te gjitha elementet e veprës penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurës dhe e njëjta është penalisht përgjegjëse. Sa i parket fajësisë e pandehura ka qene e vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer, faktin se e pandehura me pare nuk ka qene e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj saj nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurës gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, vërejtja gjyqësore e shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është vendim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e saj; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro, duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,  
P.nr.941/19 dt. 14.04.2021**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Selvane Bukleta

**GJYQTARI**  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.